



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Gjeoshkencave”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**(Auditim Përputhshmërie)**

**INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE**

**SHTATOR 2023**

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3-5
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	5-6

**II. HYRJA**

1. Objekti i auditimit.....	7
2. Qëllimi i auditimit.....	7
3. Identifikimi i çështjes.....	7
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	7
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	8
6. Kriteret e vlerësimit.....	8
7. Standardet e auditimit.....	8
8. Metodot e auditimit.....	8
9. Dokumentimi i auditimit.....	8-9

**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	9-10
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.....	10
2.1. Auditimi mbi veprimtarinë dhe funksionimin e Institutit të Gjeoshkencave.....	10-12
2.2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.....	12-15
2.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	15-19
2.4. Mbi studimin dhe vlerësimin e rrezikut sizmik, rrezikut hidrologjik dhe ndryshimeve klimatike, kryerja e studimeve me karakter përgjithësues dhe aplikativ, si dhe veprimtaria akademike për transferimin e njohurive në fushat e përgjegjësisve.....	19-28
2.5. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	28-32

**IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....**32-34**V. ANEKSE.....**34**VI. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT.....**34

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 331/1, datë 20.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, në Institutin e Gjeoshkencave, nga data 24.04.2023 deri më 26.06.2023, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022, u krye auditimi i Përputhshmërisë së veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave.

Grupi i auditimit, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë dhe funksionimin e Institucionit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, hartimin dhe zbatimin e buxhetit mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave si dhe kuadrin ligjor rregullator mbi marrëdhëniet e punës dhe pagat.

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) është një qendër kombëtare e kërkimit shkencor në Shqipëri, në fushën e gjeologjisë rajonale dhe të aplikuar, sizmologjisë, meteorologjisë, hidrologjisë, si dhe mjedisit. IGJEO synon të kontribuojë në mësimdhënien për një arsim të thelluar universitar të studentëve, si dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj, duke kombinuar kërkimin shkencor të avancuar dhe inovativ me përvojat arsimore në fushën e gjeoshkencës.

IGJEO, ish-Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), është Njësi kryesore në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT).

Sa më sipër, Instituti i Gjeoshkencave vepron mbi bazën ligjore të mëposhtme:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”;
- Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit;
- VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”;
- VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 11.01.2019 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë;
- Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Rektoratit të UPT nr. 54, datë 05.03.2021.

Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi dhe evidentimi nëse veprimtaria dhe funksionimin e Institucionit janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, nëse hartimi dhe zbatimi i buxhetit mbështetet në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave si dhe përputhshmëria e kuadrit ligjor rregullator mbi marrëdhëniet e punës dhe pagat.

### 2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga verifikimi në terren rezulton se stacioni sizmik i Sh. ka problematika, godina në të cilën ndodhen pajisjet janë në kushte jo të mira dhe mungon infrastruktura. Kjo gjendje sjell një risk për dëmtimit të pajisjeve, gjithashtu	10-12	I Lartë	Titullari i institucionit të IGJEO-s në bashkëpunim me UPT të marrin masa për planifikimin dhe realizimin e investimeve të nevojshme në stacionet sizmologjike në vend, me qëllim sigurimin e

	cenohet seriozisht aktiviteti i monitorimit sizmik në vend, si marrjes së të dhënave jo të plota dhe të pasakta mbi monitorimin e aktivitetit sizmologjik në vend.			kushteve optimale për monitorimin e aktivitetit sizmik në vend.
2	Nga auditimi rezulton një shkallë të ulët e realizimit të Investimeve, e cila tregon se niveli i bashkëpunimit midis Institutit të Gjeoshkencave dhe Universitetit Politeknik të Tiranës është i pamjaftueshëm dhe mbart riskun e ndryshimit të destinacionit të Investimeve të parashikuara për IGJEO nga ana e UPT i cili realizon procedurat e prokurimit për Institucionet e varësisë. Sipas vlerësimit të audituesve shtetëror të pavarur, realizimi i investimit për IGJEO rezulton të jetë shumë i ulët në krahasim me planifikimin për secilin vit respektiv, përkatësisht për vitin 2021, Shpenzimet kapitale të trupëzuara (Investimet) janë realizuar në masën 8,8%, ndërsa për vitin 2022 janë realizuar në masën 41%.	12-15	<b>I Lartë</b>	IGJEO të rrisë shkallën e bashkëpunimit me UPT në mënyrë që të merren masa për realizimin e programit vjetor të investimeve sipas planifikimit të fondeve të miratuara në PBA me qëllim të përdorimit sa më eficient të tyre.
3	Nga auditimi rezulton se në procedurat e rekrutimit në punë të punonjësve dhe administrimit e dokumentacionit të nevojshëm në dosjet e personelit, ka mangësi: 1. Dosjet e personelit dhe disa nga kontratat e rinovuara nuk administrohen nga IGJEO, në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Institutit. 2. Mungojnë të dhëna dhe informacionet mbi kohën e publikimit të njoftimit në APP në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Institutit. Në procesverbalin e komisionit ad-hoc të ngritur për vlerësimin e kandidatëve shprehet se komisioni mori vendimin për kalimin e fazës së parë por pa detajuar mbi mënyrat e komunikimit të kandidatëve të shpallur fitues. Kriteret e vendosura nuk janë të unifikuara për sa i përket mesatares, diplomës etj. vendosur jo sipas përcaktimeve në statutin e UPT mbi minimumin e mesatares së ponderuar.	15-19	<b>I mesëm</b>	Specialisti i personelit në IGJEO-s, të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës. Titullari i Institucionit të IGJEO-s të marrë masa për përcaktimit e kriterëve të punësimit të unifikuara sipas përcaktimeve në statutin e UPT në të gjitha procedurat e punësimit, dhe praktikat e punësimit të shoqërohet për transparencë me datën e publikimit në APP.
4	Nga auditimi rezulton se: - IGJEO nuk disponon laborator për kryerjen e analizave të	19-28	<b>I Lartë</b>	Titullari i institucionit të IGJEO-s dhe drejtorët e departamenteve përkatëse,

	<p>ndryshme, i cili referuar rregullores së Departamentit të Gjeologjisë e vitit 2022, Departamenti i Gjeologjisë ka dhe laboratorin në Institut.</p> <p>- Mungon një dokumentacion / regjistër i arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, si gjurmë mbi zbatimin e një prej pikave kryesore në misionin e Institucionit, që ka të bëjë me formimin universitar, i thelluar, të studentëve dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj.</p> <p>- Gjatë periudhës objekt auditimi puna studimore mbi vlerësimin i Biomassës ka qenë mjaft e reduktuar nga ana e Departamentit të Hidrologjisë, studimi i së cilës është ndër objektivat e institucionit.</p> <p>- Mungojnë të dhëna mbi zhvillimin të modeleve gjeo-informatike gjatë periudhës objekt auditimi, e cila është një nga detyrat e Institutit referuar rregullores në fuqi.</p> <p>- Mungon në strukturën e IGJEOs një njësi e specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore brenda fushës së veprimtarisë së Institucionit, si një nga fushat prioritare të veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave.</p>			<p>sipas detyrave të tyre funksionale të marrin masa për ngritjen e laboratorit, mbajtjen e një regjistri të arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, zhvillimin e studimeve mbi biomasën dhe zhvillimin e modeleve gjeo-informatike. Gjithashtu ngritjen dhe përfshirjen në strukturën e IGJEO-s të një njësie të specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore, me qëllim arritjen e objektivave të Institucionit.</p>
5	<p>Nga auditimi rezulton se nuk janë kryer procedurat e inventarizimit fizik të pasurisë për stacionet sizmike, hidrologjike dhe meteorologjike, pronësi e IGJEO-s, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 74.</p>	19-28	<b>I Lartë</b>	<p>Titullari i institucionit të IGJEO-s, të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimin e aktiveve në pronësi të Institutit, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.</p>

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

Në bazë të punës së kryer në Institutin e Gjeoshkencave të përshkruar në këtë raport përveç rasteve si:

- Stacioni sizmik i Sh. ka problematika, godina në të cilën ndodhen pajisjet janë në kushte jo të mira dhe mungon infrastruktura.
- Shkalla e ulët e realizimit të Investimeve, e cila tregon se niveli i bashkëpunimit midis Institutit të Gjeoshkencave dhe Universitetit Politeknik të Tiranës është i pamjaftueshëm pasi realizimi i investimit për IGJEO rezulton të jetë shumë i ulët në krahasim me planifikimin për secilin vit respektiv.
- Dosjet e personelit dhe disa nga kontratat e rinovuara nuk administrohen nga IGJEO. Në procedurat e punësimit mungojnë të dhëna dhe informacionet mbi kohën e publikimit të njoftimit APP, kriteret e vendosura nuk janë të unifikuara për sa i përket mesatares, diplomës etj.
- IGJEO nuk disponon laborator për kryerjen e analizave të ndryshme, mungon dokumentacioni /

regjistri i arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, gjatë periudhës objekt auditimi puna studimore mbi vlerësimin i Biomassës dhe zhvillimin e modeleve gjeo-informatike ka qenë mjaft i reduktuar ose mungon, si dhe mungesa në strukturën e IGJEO e një njësie të specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore.

- Gjithashtu nuk janë kryer procedurat e inventarizimit fizik të pasurisë për stacionet sizmike, hidrologjike dhe meteorologjike, pronësi e IGJEO-s, asgjë tjetër nuk ka ardhur në vëmendjen tonë që të na bëjë ne të besojmë se çështja nuk është në përputhje në të gjithë aspektet materiale me kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret mbi të cilën ushtron veprimtarinë Instituti i Gjeoshkencave.

## **OPINIONI I AUDITIMIT**

### **Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i Modifikuar/ kualifikuar)<sup>1</sup>**

Bazuar në punën e kryer të auditimit, ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave, me kriteret e vlerësimit përfshirë zbatimin e kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret për të vlerësuar nëse çdo aspekt material, nëse është në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin mbi të cilën ushtron veprimtarinë Instituti.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Institutit të Gjeoshkencave janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar/kualifikuar e shprehur kjo në bazën për opinion.

#### **Baza për kufizimin e sigurisë të opinionit të përputhshmërinë**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s). Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56 datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet shtetërore, KLSH është institucioni i pavarur nga subjekti i audituar dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Nga auditimi i përputhshmërisë, dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Bazuar në punën e kryer të auditimit, kemi zbuluar se përveç rasteve të përshkruara me lart në konkluzion, aktiviteti i IGJEO-s, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator, kemi arritur në përfundimin se veprimtaria e institucionit përmban gabime të konsideruara ***materiale dhe jo të përhapura për të cilën japim opinion të kualifikuar.***

#### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:**

Strukturat drejtuese të Institutit të Gjeoshkencave janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

#### **Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit të auditimit. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet / gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur sipas përcaktimeve ligjore është vendosur që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

<sup>1</sup> Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 24, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.2: “Në varësi të masës së mospërputhjes, kjo mund të rezultojë në: (i) Opinion të kualifikuar (nëse rastet e mospërputhjeve janë materiale, por jo të përhapura): “Bazuar në punën e kryer të auditimit, kemi zbuluar se, përveç [përshkruaj përjashtimin...], Informacioni mbi çështjen e subjektit të audituar është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuara [...]”; ose (ii) Opinion të kundërt nëse aspektet e mospërputhjeve janë materiale dhe të përhapura): “-Sipas mendimit tonë, [objekti / çështja/ lënda...] nuk është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara [ . ] , dhe mospërputhja është e përhapur”.

## **II. Hyrja.**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 331/1, datë 20.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, në Institutin e Gjeoshkencave, nga data 24.04.2023 deri më 26.06.2023, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022, u krye auditimi i Përputhshmërisë së veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. S. (përgjegjës grupi),
2. B. B., anëtar.

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

**1. Objekti i auditimit** janë dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë dhe funksionimin e Institucionit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, hartimin dhe zbatimin e buxhetit mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave si dhe kuadrin ligjor rregullator mbi marrëdhëniet e punës dhe pagat.

**2. Oëllimi i auditimit** është, vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet është, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Instituti i Gjeoshkencave, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) është një qendër kombëtare e kërkimit shkencor në Shqipëri, në fushën e gjeologjisë rajonale dhe të aplikuar, sizmologjisë, meteorologjisë, hidrologjisë, si dhe mjedisit. IGJEO synon të kontribuojë në mësimdhënien për një arsim të thelluar universitar të studentëve, si dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj, duke kombinuar kërkimin shkencor të avancuar dhe inovativ me përvojat arsimore në fushën e gjeoshkencës.

Instituti i Gjeoshkencave monitoron dhe vlerëson rreziqet natyrore si tërmetet, stuhitë, ortekët, përmbytjet, thatësitat, zjarret, tektonikën aktive, rrëshqitjet masive të shpateve kodrinore dhe malore, erozionin e tokës etj., me qëllim uljen e riskut.

IGJEO, ish-Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), është Njësi kryesore në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT), pjesë e tij në bazë të VKM-së nr. 560 , datë 22.08.2007 dhe 561, datë 22.08.2007 (“Për bashkimin e disa instituteve dhe njërive kërkimore të Akademisë së Shkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës”), si dhe Urdhrit të ish-MASH, Nr. 371, datë 28.07.2011 (“Për krijimin e Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), pranë Universitetit Politeknik të Tiranës”).

Ky institucion kombëtar, i vetëm në fushën e Gjeoshkencave, është bashkim i dy ish-instituteve të kërkimit, atij të Gjeoshkencave (IGJEO) dhe ish-Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM).

Më datë 27.07.2021, me vendim të Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës (SAUPT), Nr. 36, date 27.07.2021, emri i Institutit është “Instituti i Gjeoshkencave”. Me anë të këtij vendim u miratua dhe ndryshimi i emërtimi i dy prej Departamenteve, përkatësisht Departamenti i Klimës dhe Mjedisit u bë Departamenti i Meteorologjisë dhe Departamenti i Ekonomisë Ujore dhe Energjisë së Rinovueshme u bë Departamenti i Hidrologjisë.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Instituti i Gjeoshkencave ka si qëllim kryesor kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar, formimin universitar të thelluar të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj, transferimin e njohurive dhe teknologjive, si dhe monitorimet në shkallë kombëtare në fushat e sizmologjisë, hidrometeorologjisë, pasurive natyrore, të gjeo-riskut, gjeo-inxhinierisë, gjeo-informacionit, klimës dhe mjedisit. IGJEO është përgjegjëse për zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, hartimi i programit buxhetor afatmesëm të institucionit të IGJEO-s bëhet nga

Instituti dhe miratohet nga Rektorati i Universitetit Politeknik, duke qenë se UPT është Njësi Kryesore e UPT.

### **5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH**

Objekti ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të IGJEO-s, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit, ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

### **6. Kriteret e vlerësimit**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”;
- Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit;
- VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”;
- VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 11.01.2019 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë;
- Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Rektoratit të UPT nr. 54, datë 05.03.2021.

### **7. Standardet e Auditimit**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI);
- ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë;
- Libri Jeshil i GAO-s;
- Manuali i auditit të Përputhshmërisë.

### **8. Metodat e auditimit**

Auditimi ynë përfshin përputhshmërinë e aktivitetit të IGJEO-s, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe kuadrin ligjor rregullator mbi marrëdhëniet e punës. Zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator mbi aktivitetin për kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar, formimin universitar të thelluar të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj, transferimin e njohurive dhe teknologjive, si dhe monitorimet në shkallë kombëtare në fushat e sizmologjisë, hidrometeorologjisë, pasurive natyrore, të gjeo-riskut, gjeo-inxhinierisë, gjeo-informacionit, klimës dhe mjedisit.



## **9. Dokumentimi i auditimit**

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë është realizuar, në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), mbështetur në ISSAI-n 10 “*Deklarata e Meksikës*”, mbi Pavarësinë e (SAI), si dhe ISSAI 30 Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”; Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së si dhe Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017, e ndryshuar me Vendimin nr. 63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

Grupi i audituesve, *për të realizuar objektin e auditimit*, për dhënien e opinionit të përputhshmërisë e veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave u fokusua mbi zbatimin në mbështetje të kuadri rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat mbi zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe kuadrin ligjor mbi marrëdhëniet e punës. Zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator mbi aktivitetin për kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar, formimin universitar të thelluar të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj, transferimin e njohurive dhe teknologjive, si dhe monitorimet në shkallë kombëtare në fushat e sizmologjisë, hidrometeorologjisë, pasurive natyrore, të gjeo-riskut, gjeo-inxhinierisë, gjeo-informacionit, klimës dhe mjedisit.

Në zbatim të Ligjit organik të KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Ligjit nr. 45/2019, “*Për mbrojtjen civile*”; Ligjit nr. 80/2015, “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligjeve vjetore të buxhetit të shtetit; VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi*”; VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “*Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik*”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”; Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 11.01.2019 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë; Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Rektoratit të UPT nr. 54, datë 05.03.2021.

## **II. PËSHKRIMI AUDITIMIT**

### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) është një qendër kombëtare e kërkimit shkencor në Shqipëri, në fushën e gjeologjisë rajonale dhe të aplikuar, sizmologjisë, meteorologjisë, hidrologjisë, si dhe mjedisit. IGJEO synon të kontribuojë në mësimdhënien për një arsim të thelluar universitar të studentëve, si dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj, duke kombinuar kërkimin shkencor të avancuar dhe inovativ me përvojat arsimore në fushën e gjeoshkencës.

Instituti i Gjeoshkencave monitoron dhe vlerëson rreziqet natyrore si tërmetet, stuhitë, ortelet, përmblytjet, thatësitat, zjarret, tektonikën aktive, rrëshqitjet masive të shpateve kodrinore dhe malore, erozionin e tokës etj., me qëllim uljen e riskut.

IGJEO, ish-Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), është Njësi kryesore në Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), pjesë e tij në bazë të VKM-së nr. 560, datë 22.08.2007 dhe 561, datë 22.08.2007 (“*Për bashkimin e disa instituteve dhe njërive kërkimore të Akademisë së Shkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës*”), si dhe Urdhrit të ish-MASH, Nr. 371, datë 28.07.2011 (“*Për krijimin e Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), pranë Universitetit Politeknik të Tiranës*”).

Ky institucion kombëtar, i vetëm në fushën e Gjeoshkencave, është bashkim i dy ish-instituteve të kërkimit, atij të Gjeoshkencave (IGJEO) dhe ish-Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM).

Më datë 27.07.2021, me vendim të Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës (SAUPT), Nr. 36, date 27.07.2021, emri i Institutit është “Instituti i Gjeoshkencave”. Me anë të këtij vendim u miratua dhe ndryshimi i emërtimi i dy prej Departamenteve, përkatësisht Departamenti i Klimës dhe Mjedisit u bë Departamenti i Meteorologjisë dhe Departamenti i Ekonomisë Ujore dhe Energjisë së Rinovueshme u bë Departamenti i Hidrologjisë.

## 2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1. AUDITIMI MBI VEPRIMTARINË DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE

Instituti i Gjeoshkencave ka për mision:

- a) Kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar;
- b) Formimin universitar të thelluar të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj;
- c) Transferimin e njohurive dhe teknologjive, si dhe monitorimet në shkallë kombëtare në fushat e sizmologjisë, hidrometeorologjisë, pasurive natyrore, të gjeo-riskut, gjeo-inxhinierisë, gjeo-informacionit, klimës dhe mjedisit.

Detyrat kryesore të IGJEO-s janë:

- Monitorimi, regjistrimi dhe analizimi i vazhdueshëm i aktivitetit sizmik të vendit, nëpërmjet rrjeteve kombëtare të monitorimit sizmik dhe gjeodinamik, si dhe njoftimin në kohë reale i organizmave shtetërorë përgjegjëse për emergjencat civile dhe i publikut për rreziqet nga tërmetet;
- Studime të thelluara në fushën e sizmologjisë dhe sismoteknikës për tërmetet që godasin vendin tonë;
- Studimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i dukurive dhe veprimtarisë hidrologjike, si dhe njoftimi në kohë reale i organizmave shtetërorë përgjegjëse për emergjencat civile dhe i publikut për rreziqet nga përmytjet; rreziqet nga zjarret në pyje etj.
- Studimi i fenomeneve gjeologjike (rrëshqitjet e shpateve kodrinore-malore, erozione, tektonike, lëngëzimi i rërave etj.) dhe ndërtimi i hartave gjeologjike tematike;
- Studimi dhe vlerësimi i pasurive minerale të ndërtimit, burimeve nëntokësore, të energjisë, resurseve ujore nëntokësore;
- Studimi i rreziqeve natyrore (gjeoriskut) dhe atyre të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut (rrëshqitjet, erozionet, përmytjet, tërmetet, ndotjet, vend depozitat, subsidencat minerare etj.);
- Zhvillimi i modeleve gjeo-informatike;
- Studimi dhe monitorimi i dukurive atmosferike të motit dhe ndryshimet klimaterike, si dhe njoftimin në kohë reale i organizmave shtetërorë përgjegjëse për emergjencat civile dhe i publikut për rreziqet nga ngjarjet e jashtëzakonshme atmosferike.

IGJEO aktualisht përbëhet nga 4 departamente, si më poshtë:

1. Departamenti i Gjeologjisë;
2. Departamenti i Hidrologjisë;
3. Departamenti i Meteorologjisë;
4. Departamenti i Sizmologjisë.

Nga veprimtaria e secilit departament Institucioni/UPT ka përfituar të ardhura sipas viteve (në lekë), si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: Te ardhurat nga Departamentet gjatë periudhën objekt auditimi:

Në lekë

Nr.	Të ardhura sipas viteve	Departamenti i Gjeologjisë	Departamenti i Hidrologjisë	Departamenti i Meteorologjisë	Departamenti i Sizmologjisë	Projekte	TOTAL
1	2020		64,080	70,848	360,000		494,928
2	2021		298,800	102,720			401,520
3	2022			8,315,106	120,000	492,242	8,927,348
	<b>Totali</b>		<b>362,880</b>	<b>8,488,674</b>	<b>480,000</b>	<b>492,242</b>	<b>9,823,796</b>

Burimi IGJEO, punuar nga grupi i auditimit.

Tarifat për shërbimet ndaj të tretëve janë miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ të Universitetit Politeknik nr. 5, datë 12.09.2014.

Departamenti i Gjeologjisë ka kryen oponenca teknike në llogari të UPT.

Departamenti i Hidrologjisë të ardhurat i kanë nga shërbime dhe të dhëna hidrologjike për palët e treta.

Departamenti i Meteorologjisë të ardhurat i kanë kryesisht nga shërbime meteorologjike sipas kërkesave të palëve të treta.

Departamenti Sizmologjik të ardhurat e përfituara në vitin 2020 janë nga vërtetimet sizmike.

Për pajisjen me leje ndërtimi të objekteve ndërtimore kërkohet dokumentacioni i përcaktuar në nenin 15 të VKM Nr. 408, Datë 13.5.2015, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, ku ndër dokumentacionet shoqërues të Projektit Konstruktiv duhen dhe studimi gjeologjik dhe sizmik nga projektuesit të licencuar.

Referuar VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar, Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, përcaktohet në lidhjen 2, pika 12, Studime të sizmologjisë inxhinierike, vetëm shoqëri/subjekte juridike licencohen për kryerjen e studimeve të ndryshme sizmologjike.

Shoqëritë/Subjektet që do të licencohen duhet të plotësojnë kriteret e specifikuar në pikën 12, lidhja 4. Sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga viti 2014 lejohen dhe subjektet private të licencuara të kryejnë studime sizmologjike për projekte të ndryshme që aplikojnë për leje ndërtimi.

Vërtetimet sizmike të lëshuara nga Institucioni gjatë vitit 2020, nga janari 2021 nuk janë kryer nga IGJEO pasi me daljen e VKM Nr. 1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi", leje të cilat tashmë jepen me anë të sistemit të e-albania.

Sipas kësaj VKM pika 1 citohet se: "Të gjitha subjektet, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi ose leje ndërtimi, për të cilat nuk nevojitet pajisja paraprake me një leje zhvillimi, duhet që fillimisht të pajisen me një vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen, për të cilën këto subjekte paraqesin kërkesë".

Pika 8 citohet se: "Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës, organi kompetent për pajisje me leje zhvillimi/ndërtimi mund të kërkojë ekspertizë teknike nga organe të tjera që kanë njohuri teknike mbi fushat për të cilat do të kryhet vlerësimi, për të lëshuar vërtetimin për riskun".

Sipas kësaj VKM vërtetimi për riskun lëshohet nga organi kompetent për pajisjen me leje ndërtimi që janë Këshilli Kombëtar për Territorin, Bashkitë, por mund të kërkojnë mendim nga organet kompetente për vlerësim risku.

IGJEO, pas kërkesave të ardhur nga Bashkitë për periudhën Janar 2021-Dhjetor 2022, ka dhënë mendime përmes sistemit elektronik "e-Leje", të cilat jepet në sistemin e-albania pa pagesë.

Ndërsa në vitin 2022 të ardhurat e DS kanë ardhur nga shërbime me të tretët për të dhëna sizmike.

Bazuar në misionin dhe detyrat kryesore të IGJEO-s, stafit të punonjësve shkencorë dhe infrastrukturës që zotëron, DS ka për detyrë: Monitorimi, regjistrimi dhe analizimi i vazhdueshëm i aktivitetit sizmik të vendit, nëpërmjet rrjeteve kombëtare të monitorimit sizmik dhe gjeodinamik, si dhe njoftimin në kohë reale i organizmave shtetërorë përgjegjëse për emergjencat civile dhe i publikut për rreziqet nga tërmetet; Studime të thelluara në fushën e sizmologjisë dhe sizmoteknikës për tërmetet që godasin vendin tonë. Grupi i auditimit e konsideroi të nevojshme verifikimin e gjendjes në të cilën ndodhen stacionet e sizmike dhe pajisjet e tyre.

Stacionet sizmike fillimisht kanë qenë analoge ndërsa sot me instalimin e teknologjisë dixhitale të regjistrimit dhe transmetimit të sinjalit sizmik, dhe regjistrohen dhe monitorohen nga qendra e monitorimit e vendosur në godinën e Institutit të Gjeoshkencave. Vëzhguesit në stacione kryejnë funksionin e rojës së aparaturave dhe vëzhguesin e funksionimit të tyre, si dhe ndonjë shërbim tjetër sekondar.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Gjendja e stacioneve
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi në terren rezulton se stacioni sizmik i Sh. ka problematika, godina në të cilën ndodhen pajisjet janë në kushte jo të mira dhe mungon infrastruktura. Kjo gjendje sjell një risk për dëmtimit të pajisjeve, gjithashtu cenohet seriozisht aktiviteti i monitorimit sizmik në vend, si marrjes së të dhënave jo të plota dhe të pasakta mbi monitorimin e aktivitetit sizmologjik në vend.
<b>Kriteri:</b>	Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Rektoratit të UPT nr. 54, datë 05.03.2021.
<b>Ndikimi:</b>	Risk për dëmtimit e pajisjeve brenda këtyre stacioneve, marrjen e të dhënave jo të plota dhe të pasakta dhe zhvillimin e aktivitetit monitorues në kushte të përshtatshme.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e investimeve të nevojshme.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i institucionit të IGJEO-s në bashkëpunim me UPT të marrin masa për planifikimin dhe realizimin e investimeve të nevojshme në stacionet sizmologjike në vend, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për monitorimin e aktivitetit sizmik në vend.

## 2.2. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programi Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, PBA-në 2022-2024 dhe PBA-në 2023-2025;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2021 dhe vitin 2022, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

### *Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të PBA.*

Hartimi i programit buxhetor afatmesëm i institucionit të IGJEO-s bëhet nga Instituti dhe miratohet nga Rektorati i Universitetit Politeknik, si Njësi Kryesore e Rektoratit të Universitetit Politeknik. Fillimisht Drejtoria Ekonomike e UPT, u dërgon të gjithë institucioneve të varësisë, shkresën mbi hartimin e PBA, duke përcaktuar udhëzimet dhe prioritetet, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe shkencën në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Prioritetet kryesore të projektbuxhetit të përcaktuara nga UPT, janë si më poshtë:

- Llogaritja e të ardhurave dytësore që secila njësi do të krijojë për periudhën e përcaktuar. Specifikimi i të ardhurave që do të krijohen sipas natyrës, bazuar në ecurinë statistikore të viteve të mëparshme si dhe të dhënat për të ardhurat që mund të krijojë;
- Kërkesat e njërive për fond page e sigurime shoqërore;
- Kërkesat për shpenzime operative;
- Kërkesat për transferta jashtë për organizata ndërkombëtare;
- Kërkesat për ndihma të menjëhershme për punonjësit;
- Kërkesat për investime, të specifikuara.

Shkresa e UPT, pas protokollimit u dërgohet departamenteve përkatëse përfshirë dhe degën e financës.

Secili nga departamentet përgatit kërkesat e tyre sipas tabelave orientuese që parashikon baza ligjore në fuqi, të cilat më pas mblidhen dhe përpunohen nga departamenti i financës në IGJEO. Departamenti i Financës kryen përpunimin, llogaritjet dhe plotësimin e pasqyrave, duke marrë në konsideratë dhe sasinë gjendje të materialeve në magazinë.

Pas përfundimit, dërgohet në Rektorat kërkesat buxhetore të IGJEO me të gjitha pasqyrat dhe relacionin përkatëse.

Para mbylljes së vitit ushtrimor, rektorati u dërgon Institucioneve të varësisë, me anë të një shkrese kërkesë mbi llogaritjen më të saktë bazuar në realizimin deri në atë kohë.

Në fillim të vitit ushtrimor miratohet me vendim të bordit të administrimit Programi Buxhetor

Afatmesëm, dhe u përcillet Institucioneve të varësisë, ku paraqitet buxheti për secilën njësi i specifikuar me të gjitha zërat.

Njësia zbaton planin e vendosur nga Bordi i Administrimit, dhe për çdo ndryshim eventual brenda zërave, njësia mund të kërkojë rialokim fondesh, e cila miratohet nga Bordi i Administrimit.

**a) Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimet shkencore në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, IGJEO është njësi kryesore e UPT, e cila mbulon fushat e kërkimit shkencor dhe realizon ekspertiza në fushën e gjeologjisë, sizmologjisë, meteorologjisë, hidrologjisë dhe mjedisit.

Institucionet e arsimit të lartë funksionojnë sipas parimit të autonomisë financiare, ku hartojnë një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës. Përdorimi fondeve publike nga Buxheti i Shtetit për institucionet e arsimit të lartë bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar. Bordi i Administrimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.

Për vitin 2021, buxheti i miratuar për IGJEO/UPT, është paraqitur në një program buxhetor i cili i është akorduar UPT, me kod., miratuar nga Rektori i UPT me shkresën nr. 1877 prot., datë 16.11.2021, protokolluar në IGJEO nr. 430 prot., datë 16.11.2021.

Për vitin 2022, buxheti i miratuar për IGJEO/UPT, buxheti i miratuar për IGJEO, është paraqitur në një program buxhetor i cili i është akorduar UPT, me kod., miratuar nga Rektori i UPT me shkresën nr. 874 prot., datë 19.04.2022.

**b) Zbatimi i kritereve në realizimi i planit të buxhetit.**

Detajimi i PBA të IGJEO është bërë mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 137, datë 16.12.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”.

**Viti 2021**

Me shkresën nr. 733 prot., datë 09.07.2020, protokolluar në IGJEO me nr. 226 prot., datë 10.07.2020, Drejtoria Ekonomike në Rektori të Universitetit Politeknik të Tiranës, i ka dërguar IGJEO-s (si një nga Institucionet e varësisë së saj), kërkesën për nisjen e procedurave mbi hartimin e PBA 2021-2023.

IGJEO ka dërguar me shkresën nr. 226/1 prot., datë 28.07.2020, PBA 2021-2023 të IGJEO-s, të plotësuar për secilën nga zërat.

Për vitin 2021, totali i të ardhurave të parashikuara nga shërbimet me të tjerë (artikulli 71110) është 700,000 lekë.

Shpenzimet e IGJEO-s në total për vitin 2021, ishin planifikuar në shumën 137,219 mijë lekë. Ato janë realizuar në vlerën 95,748 mijë lekë, ose 41,471 mijë lekë më pak se parashikimi.

Më poshtë paraqitet tabela e shpenzimeve për vitin 2021:

*Analiza e shpenzimeve të realizuara nga IGJEO-s për vitin 2021*

Tabela 2:

Në lekë

Nr	Artikulli	Emërtimi i shpenzimeve	Plan	Fakt	% realizimit
1	600	Paga	73,669,955	68,482,134	92.9%
2	601	Sigurime Shoqërore	10,000,000	9,360,714	93.6%
3	602	Mallra dhe shërbime	16,670,000	14,860,883	89.1%
4	605	Transferimet korrente me jashtë vendit	3,990,000		0%
5	606	Transferta për buxhete familjare dhe Individë	330,005	330,005	100%
6	230	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	1,550,000		0%

7	231	Shpenzime kapitale të trupëzuara	31,009,000	2,713,980	8.8%
		<b>Totali</b>	<b>137,218,960</b>	<b>95,747,716</b>	<b>69.8%</b>

Burimi: IGJEO, përpunuar nga grupi i auditimit

Zërat e shpenzimeve për pagën e punonjësve dhe sigurimeve shoqërore janë realizuar respektivisht në masën 92.9% dhe 93.6%.

Shuma e planifikuar për artikullin 602-Mallra dhe Shërbime është 16,670 mijë lekë, dhe është realizuar 14,861 mijë lekë, ose 89.1%.

Llogaria 605 - Transferta korrente me jashtë vendit është parashikuar në shumën 3,990 mijë lekë dhe nuk është realizuar.

Llogaria 606 - Transferta për buxhete familjare dhe Individë është parashikuar në shumën 330 mijë lekë dhe realizuar 330 mijë lekë, ose 100%.

Llogaria 230 - Shpenzime kapitale të trupëzuara është parashikuar në shumën 1,550 mijë lekë dhe nuk është realizuar.

Llogaria 231 - Shpenzime kapitale të trupëzuara është parashikuar në shumën 31,009 mijë lekë dhe realizuar 2,714 mijë lekë, ose 8.8%, pasi nuk janë realizuar 28,295 mijë lekë investime për arsye të mos realizimit të procedurave të prokurimit nga Rektorati i Universitetit Politeknik.

### Viti 2022

Me shkresën nr.1043 prot., datë 14.06.2021, Drejtoria Ekonomike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, i ka dërguar IGJEO-s (si një nga Institucionet e varësisë së saj), kërkesën për nisjen e procedurave mbi hartimin e PBA 2022-2024.

Për vitin 2022, totali i të ardhurave të parashikuara për shërbime për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre për konsulenca studime ekspertiza etj (artikulli .) është 550,000 lekë.

Shpenzimet e IGJEO-s në total për vitin 2022, ishin planifikuar në shumën 150,482 mijë lekë. Ato janë realizuar në vlerën 119,426 mijë lekë, ose 31,056 mijë lekë më pak se parashikimi.

Më poshtë paraqitet tabela e shpenzimeve për vitin 2022:

*Analiza e shpenzimeve të realizuara nga IGJEO-s për vitin 2022*

Tabela 3:

Në lekë

Nr	Artikulli	Emërtimi i shpenzimeve	Plan	Fakt	% realizimit
1	600	Paga	76,407,775	73,775,957	96.6%
2	601	Sigurime Shoqërore	10,100,000	10,088,038	99.9%
3	602	Mallra dhe shërbime	22,336,800	14,465,837	64.8%
4	605	Transferimet korrente me jashtë vendit	7,500,000	6,446,563	86%
5	606	Transferta për buxhete familjare dhe Individë	1,080,225	1,080,225	100%
6	230	Shpenzime kapitale të trupëzuara			
7	231	Shpenzime kapitale të trupëzuara	33,057,000	13,568,945	41%
		<b>Totali</b>	<b>150,481,800</b>	<b>119,425,565</b>	<b>79.4%</b>

Burimi: IGJEO, përpunuar nga grupi i auditimit

Zërat e shpenzimeve për pagën e punonjësve dhe sigurimeve shoqërore janë realizuar respektivisht në masën 96.6% dhe 99.9%.

Shuma e planifikuar për artikullin 602-Mallra dhe Shërbime është 22,336 mijë lekë, dhe është realizuar 14,465 mijë lekë, ose 64.8%.

Llogaria 605 - Transferta korrente me jashtë vendit është parashikuar në shumën 7,500 mijë lekë dhe është realizuar 6,446 mijë lekë, ose 86%.

Llogaria 606 - Transferta për buxhete familjare dhe Individë është parashikuar në shumën 1,080 mijë lekë dhe realizuar 1,080 mijë lekë, ose 100%.

Llogaria 231 - Shpenzime kapitale të trupëzuara është parashikuar në shumën 33,057 mijë lekë dhe realizuar 13,568 mijë lekë, ose 41%, pasi nuk janë realizuar 19,489 mijë lekë investime nga të cilat 9,361 mijë lekë për arsye të anulimit dy herë të procedurave të prokurimit nga Rektorati i Universitetit Politeknik, 1,620 mijë lekë për arsye të mos realizimit të procedurave të prokurimit, 6,394 mijë lekë janë realizuar në vitin 2023 dhe 2,114 mijë lekë janë diferenca midis vlerës së parashikuar dhe asaj të fituar në procedurë prokurimi.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mbi hartimin, planifikimin dhe realizimin e Buxhetit
<b>Situata:</b>	Nga auditimi rezulton një shkallë e ulët e realizimit të Investimeve, e cila tregon se niveli i bashkëpunimit midis Institutit të Gjeoshkencave dhe Universitetit Politeknik të Tiranës është i pamjaftueshëm dhe mbart riskun e ndryshimit të destinacionit të Investimeve të parashikuara për IGJEO nga ana e UPT i cili realizon procedurat e prokurimit për Institucionet e varësisë. Sipas vlerësimit të audituesve shtetëror të pavarur, realizimi i investimit për IGJEO rezulton të jetë shumë i ulët në krahasim me planifikimin për secilin vit respektiv, përkatësisht për vitin 2021, Shpenzimet kapitale të trupëzuara (Investimet) janë realizuar në masën 8,8%, ndërsa për vitin 2022 janë realizuar në masën 41%.
<b>Kriteri:</b>	- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016; - Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit; - Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 11.01.2019 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë; - Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Rektoratit të UPT nr. 54, datë 05.03.2021.
<b>Ndikimi:</b>	Nivel i ulët realizimi të Investimeve.
<b>Shkaku:</b>	Shkalla e ulët e realizimit të Investimeve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	IGJEO të rrisë shkallën e bashkëpunimit me UPT në mënyrë që të merren masa për realizimin e programit vjetor të investimeve sipas planifikimit të fondeve të miratuara në PBA me qëllim të përdorimit sa më eficient të tyre.


### **2.3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE**

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Struktura organizative IGJEO dhe rregullorja e brendshme ;
2. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna;
3. Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;
4. Listpagesat mujore për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022.

#### **1. Struktura organizative e Institutit të Gjeoshkencave**

Organigrama e IGJEO-s funksionon si më poshtë:



Burimi: IGJEO, punuar nga grupi i auditimit

Gjatë periudhës objekt auditimi, në IGJEO (ish-IGJEUM) kanë ndodhur ndryshime në strukturë. Struktura ekzistuese (e vitit 2015) përbëhej nga 71 punonjës, struktura e re e miratuar nga Senati Akademik me vendimin nr. 13 datë 30.10.2020, sipas propozimeve të IGJEO-s, përbëhet nga 66 punonjës. Ky vendim është dërguar në IGJEUM, nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike e Rektoratit të UPT-së, me shkresën nr. 1492 prot., datë 03.12.2020.

### ***Rregullorja e brendshme e IGJEO-s***

Rregullorja e brendshme e Institutit të Gjeoshkencave, (ish-IGJEUM) është aprovuar nga Stafi Akademik më 25 Nëntor 2020, dhe miratuar nga Rektori i UPT me Vendim nr. 54, datë 05.03.2021, dërguar në IGJEO me shkresën nr. 450/3 prot., datë 30.03.2021, dhe protokolluar me nr.132 prot., datë 31.03.2021. Kjo rregullore përcakton misionin dhe rregullon aspekte të organizimit, drejtimit, administrimit, punësimit dhe sigurimit të cilësisë të punës akademike e kërkimore të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

## ***2. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna***

### ***Emërimet***

Procedura e rekrutimit të stafit në IGJEO është realizuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë. Pranimi nga detyra e punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, bazuar në rregulloren e brendshme. Kontratat e punës lidhen midis Rektorit dhe personelin në varësi.

Procedurat e rekrutimeve të reja në Institut realizohen si në vijim:

Përgjegjësi i Departamentit i dërgon Drejtorit të Institucionit, kërkesën për të plotësuar vendet vakante, së bashku me kriteret që duhet të plotësojë kandidati. Kërkesa i përcillet me shkresë Rektoratit të UPT.

Pas marrjes së kërkesës nga njësia kryesore, Rektorati dërgon njoftimi për vendet e lira të punës për shpallje në faqen e APP, ku duhet të qëndrojë me një afat 2-javë. Rektorati pas shpalljes së njoftimit i kërkon Institutit të krijojë komisionet ad-hoc për vlerësimin e kandidatëve. Komisioni ngrihet me urdhër të Drejtorit të IGJEO-s dhe miratohet me vendim të Rektorit të UPT.



Pas mbylljes së aplikimeve, Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve për vendet e lira të punës shqyrton dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët, dhe mban një procesverbal mbi vlerësimin e aplikantëve, vlerësimi kryhet në dy faza, shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe faza e dytë intervista me gojë.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, Drejtori i Institutit i dërgon vlerësimin e kandidatëve të kualifikuar të parët sipas procesverbaleve nga komisionet, për miratimin e Rektorit të UPT.

Rektorati i UPT përcjell Institutin e Gjeoshkencave vendimin e Rektorit për emërimin e personelin pas përfundimit të gjithë procedurave.

Në rastet e kontratave me afat të përcaktuar, në momentin e përfundimit të kontratave Përgjegjësit e Departamenteve njoftojnë Drejtorin e Institutit mbi përfundimin e kontratës së stafit dhe nevojën për rinovimin e kontratave. Referuar këtyre kërkesave Drejtori i Institutit i përcjell Rektoratit kërkesat për rinovim Kontrate.

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, në IGJEO janë emëruar/rekrutuar 5 punonjës dhe janë rinovuar kontratat për 5 punonjës.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, në IGJEO janë emëruar/rekrutuar 19 punonjës dhe janë rinovuar kontratat për 4 punonjës.

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, në IGJEO janë emëruar/rekrutuar 16 punonjës dhe janë rinovuar kontratat për 7 punonjës.

### ***Largimet***

#### **Largimet e punonjësve të IGJEO**

Gjatë periudhës Janar 2020 – Dhjetor 2022, në IGJEO ka pasur 8 largime të stafit të saj, nga të cilët 2 punonjës janë larguar me dorëheqje, 2 punonjësve i ka përfunduar kontrata, 1 punonjës është larguar me transferim nga Rektorati dhe 3 punonjës larguar me dalje në pension.

Në rastet e dorëheqjes nga punonjësi, punonjësi dorëzon kërkesën për dorëheqje me shkrim. Në të gjitha rastet Drejtori i IGJEO i dërgon kërkesën me dorëheqje, përfundim kontrate ose dalje në pension Rektoratit për miratim.

### ***3. Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit***

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit nuk administrohen nga IGJEO, nisur nga fakti që IGJEO është njësi kryesore në varësi të Rektoratit të UPT, në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, si dhe VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” në Universitetin Politeknik të Tiranës, kontratat e punës lidhen me Universitetin Politeknik të Tiranës, kështu që dosjet e personelit janë të dokumentuara në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në UPT.

IGJEO ka në listpagesë 257 vrojtues, të cilët mbikëqyrin fizikisht dhe ndërveprojnë rutinë me stacionet në rrjetin kombëtar sizmologjik dhe hidro-meteorologjik, vrojtuesit nuk janë pjesë e organikës së IGJEO. Ata janë punonjës me kontratë dhe paguhen në bazë të VKM nr. 227, datë 15.04.2005, që përcakton ndryshimet në vendimin nr. 406, dt. 19.6.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për forcimin e Rrjetit Hidro-Meteorologjik dhe Sizmologjik”, e ndryshuar. Kontrata individuale nënshkruhet direkt nga Universiteti (në Rektorat).

Përzgjedhja e vrojtuesve bëhet nga Departamentet dhe pas nënshkrimit të kontratës, ata trajnohen në lidhje me detyrimet dhe detyrat specifike në stacion (Departamenti Hidrologjik dhe meteorologjik). Vrojtuesit shërbejnë në stacionet e rrjetit kombëtar të menaxhuar nga IGJEO, dhe listpagesat përpilohen në këtë institucion.

Vrojtuesit në stacionet e rrjetit Hidro-Meteorologjik, shërbejnë pasi një numër i konsiderueshëm stacionesh analoge, nevojitet mbikëqyrje dhe ndërveprim për leximin e parametrave dhe ndërhyrjen në rast të defekteve emergjente, dërgimin e të dhënave fizikisht etj.

Në rast reshjesh dhe përmbytjesh, leximi në kohë nga vrojtuesit në terren, i hidrometrave në basenet e lumenjve kryesor është i rëndësishëm në parashikimin e shpejtë të situatës hidrike. Për stacionet e rrjetit sizmologjik, vrojtuesit nevojiten për ndërhyrje emergjente në rast defektesh, konstatimin e tyre dhe raportimin në kohë si dhe ruajtjen fizike, pavarësisht se ata nuk ndërveprojnë me sistemet, të cilat janë automatike.

<b>Titulli gjetjes:</b>	Dosjet e personelit.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi rezulton se në procedurat e rekrutimit në punë të punonjësve dhe administrimin e dokumentacionit të nevojshëm në dosjet e personelit, ka mangësi:</p> <p>1. Dosjet e personelit dhe disa nga kontratat e rinovuara nuk administrohen nga IGJEO, në kundërshtim me rregullores së brendshme të Institutit, neni 25 Specialisti i personelit duhet të mbajë dhe të plotësojë dokumentacionin e punonjësve me të dhëna personale, të kualifikimit të tyre, aktivitetit mësimor shkencor të personelit, librezat e punës, dosjet e tyre personale, libri themeltar i punonjësve të Institutit.</p> <p>2. Mungojnë të dhëna dhe informacionet mbi kohën e publikimit të njoftimit në APP në kundërshtim me rregullores së brendshme të Institutit, neni 20, procedurat e konkurrimit janë transparente. Në procesverbalin e komisionit ad-hoc të ngritur për vlerësimin e kandidatëve shprehet se pas shqyrtimit të dokumenteve, komisioni mori vendimin për kalimin e fazës së parë por pa detajuar mbi mënyrat e komunikimit të kandidatëve të shpallur fitues. Kriteret e vendosura nuk janë të unifikuara për sa i përket mesatares, diplomës etj. vendosur jo sipas përcaktimeve në statutin e UPT mbi minimumin e mesatares së ponderuar.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;</p> <p>Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 11.01.2019 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë;</p> <p>Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Rektoratit të UPT nr. 54, datë 05.03.2021.</p> <p>VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;</p>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Mosrespektimi i bazës ligjore dhe rregullatore ka sjell mungesën e dosjeve personale të punonjësve dhe vendosja e kriterëve për punësim është jo e unifikuar sipas përcaktimeve në statut.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i detyrave sipas rregullores së Institutit nga specialisti i personelit.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>1. Rekomandimi:</b>	Specialisti i personelit në IGJEO, të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.
<b>2. Rekomandimi:</b>	Titullari i Institucionit të IGJEO-s të marrë masa për përcaktimit e kriterëve të punësimit të unifikuara sipas përcaktimeve në statutin e UPT në të gjitha procedurat e punësimit, dhe praktikat e punësimit të shoqërohet për transparencë me datën e publikimit në APP.

#### **4. Listpagesat mujore për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022**

Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me zgjedhje listpagesat e muajve Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor 2022.

Nga auditimi i listpagesave rezultoi se përllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje i listpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listëprezencat në punë, të përgatitura nga përgjegjësit e departamenteve respektive, si dhe janë nënshkruar nga Kryetari i Degës së Financës dhe Administratori i Institutit të Gjeoshkencave.

Në sektorin e financës, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

#### **2.4. MBI STUDIMIN DHE VLERËSIMIN E RREZIKUT SIZMIK, RREZIKUT HIDROLOGJIK DHE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, KRYERJA E STUDIMEVE ME KARAKTER PËRGJITHËSUES DHE APLIKATIV, SI DHE VEPRIMTARIA AKADEMIKE PËR TRANSFERIMIN E NJOHURIVE NË FUSHAT E PËRGJEGJËSIVE**

IGJEO aktualisht përbëhet nga 4 departamente, si më poshtë:

1. Departamenti i Gjeologjisë;
2. Departamenti i Hidrologjisë;
3. Departamenti i Meteorologjisë;
4. Departamenti i Sizmologjisë.

##### **1. Departamenti i Gjeologjisë**

Departamenti i Gjeologjisë (DGJ) është njësi bazë e Institutit të Gjeoshkencave që nxit, organizon, zhvillon dhe promovon veprimtarinë kërkimore në fushën e gjeologjisë bazë dhe të aplikuar, të konsulencës mbi bazën e kontakteve dhe marrëveshjeve në fushat e veprimtarisë së tij, në përputhje me Aktet Ligjore të Arsimit të Lartë, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e Brendshme të Institutit të Gjeoshkencave dhe aktet e tjera nënligjore.

Departamenti i Gjeologjisë, ka për mision:

- Të kryejë kërkim shkencor, bazë dhe të aplikuar, në fushën e Gjeoshkencave (Gjeologjisë regjionale, tektonikes, gjeofizikes dhe geomagnetizmit);
- Të marrë pjesë në formimin universitar, të thelluar, të studentëve dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj;
- Të kryejë shërbime për të tretë dhe të ndihmojnë në transferimin e njohurive e të teknologjisë në fushat e pasurive natyrore, të Gjeoriskut, Gjeoinxhinierisë dhe Gjeoinformacionit.

##### **Kërkimi shkencor:**

Kërkimi shkencor në Departamentin e Gjeologjisë do të bazohet në trashëgiminë e pasur të studimit gjeologo–tektonik të vendit, pasurive minerale dhe gjithë fenomeneve gjeologjike. Studimi i kujdesshëm i gjithë kësaj trashëgimie në publikimet shkencore, materialet e shumta arkivore, veçanërisht në Arkivin Qendror të Gjeologjisë.

Gjatë periudhës objekt auditimi nga Departamenti i Gjeologjisë ka patur publikime artikujsh dhe pjesëmarrje në konferenca sipas tabelës nr.4.

Tabela 4: Të dhëna mbi veprimtarinë kërkimore shkencore të Departamentit të Gjeologjisë:

<i>Nr.</i>	<i>Departamenti</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Numri</i>
<b>2020</b>			
1	DGJ	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit	2
2		Artikuj në revista shkencore jashtë vendit	1
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare	3
4		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	4
5		Studime Shkencore	1
<b>2021</b>			
1	DGJ	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit, Prezantime	8
2		Artikuj në revista shkencore jashtë vendit, Prezantime	4
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	1
4		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare	7
5		Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare	3

6		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	5
7		Studime Shkencore	2
		<b>2022</b>	
1	DGJ	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit	1
2		Artikuj në revista shkencore jashtë vendit, Prezantime	6
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	2
4		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare	2
5		Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare	9
6		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	15
7		Studime Shkencore	5

*Burimi IGJEO, punuar nga grupi i auditimit.*

Etapat e ndjekura nga Departamenti i Gjeologjisë për publikim dhe pjesëmarrje në konferenca janë:

- Grumbullimi i të dhënave bashkëkohore (Departamenti i Gjeologjisë i grumbullon këto të dhëna nëpërmjet vrojtimit në terren);
- Analizimi i mostrave dhe fitimi i rezultateve të besueshme;
- Ballafaqimi i të dhënave me arritjet bashkëkohore;
- Interpretimi i të dhënave;
- Arritja e konkluzioneve me interes shkencor dhe praktik.

Referuar rregullores së Departamentit të Gjeologjisë e vitit 2022, neni 30-32 Departamenti i Gjeologjisë ka dhe laboratorin në Institut për kryerjen e analizave të ndryshme, i cili mungon.

#### **Integrimi i kërkimit me formimin universitar**

Departamenti i Gjeologjisë, në kuadër të IGJEO, është integruar me të gjitha kapacitetet kërkimore, stafin e kualifikuar akademik, burimet e informacionit, bazën teknologjike, ekspozetë muzeale etj, në formimin universitar, kryesisht për diplomat "Master" dhe "Doktor i Shkencave" në fushën e gjeoshkencave. Gjatë periudhës objekt auditimi 2020-2021 Departamenti i Gjeologjisë ka dhënë kontribut për dy doktoratura të përfunduara në vitin 2021 dhe aktualisht për dy te rinj në Departament janë në fillim te procesit.

Referuar misionit të Departamentit të gjeologjisë në formimin universitar, të thelluar, të studentëve dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj nga auditimi rezultoi mungesa e një dokumentacioni / regjistri i arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj.

#### **Shërbimet e konsulencës dhe transferimi i dijeve e teknologjisë**

Departamenti Gjeologjisë referuar misionit të kryen dhe studime me të tretë (bashki, komuna, kompani private), dhe oponenta teknike për studimin e rreziqeve gjeologjike.

Në lidhje me studimet e fenomeneve gjeologjike është ndërtuar harta Gjeoteknike e Shqipërisë në shkallë 1:200 000. Harta përbëhet nga 8 zona gjeoteknike, 16 nënzona gjeoteknike dhe 62 sheshe gjeoteknike, gjithashtu tregon dhe nivelin e ujërave nëntokësore, rrëshqitjet, subsidence, zonat me lëngëzim të rërave, zonat tektonike.




Figura 1 Harta Gjeoteknike e Shqipërisë

Gjithashtu në studimet e kryera në këtë studim tregohen dhe rreziqet nga fenomenet gjeoteknike, si erozioni, rrëshqitjet etj.

Tabela 5: Të dhëna mbi shërbime me të tretët e Departamentit të Gjeologjisë:

Nr.	Departamenti	Përshkrimi	Numri
		<b>2020</b>	
1	DGJ	Shërbime me të tretët Oponenca (në kuadër të UPT dhe në kuadër të IGJEO)	15
		<b>2021</b>	
1	DGJ	Shërbime me të tretët Oponenca (në kuadër të UPT dhe në kuadër të IGJEO) 1. Për B. T. 19 copë 2. Për Oponencat në kuadër të UPT 98 copë	117
2		Shërbime me të tretët Studime	2
		<b>2022</b>	
1	DGJ	Shërbime me të tretët Oponenca (në kuadër të UPT dhe në kuadër të IGJEO) 1. Për B. T. 6 copë 2. Për Oponencat në kuadër të UPT 151 copë	157
2		Shërbime me të tretët Studime	8

Burimi: IGJEO, punuar nga grupi i auditimit

## 2. Departamenti Hidrologjisë

Departamenti i Hidrologjisë (DH) është njësi bazë e kërkimit shkencor në Institutin e Gjeoshkencave (IGJEO), Departamenti i Hidrologjisë ka për mision dhe kryen veprimtari si mëposhtë:

- Të mbajë në gjendje funksionale Sistemin Kombëtar të Monitorimit Hidrologjik (SKMH), duke e përmirësuar dhe optimizuar atë, vlerësimin e situatave të emergjencave civile ashtu dhe për vlerësimin e pasurive të burimeve ujore. Monitorimi dhe regjistrimi i vazhdueshëm i aktivitetit hidrologjik në Shqipëri dhe drejton dhe administron Qendrën Kombëtare të Parashikimit dhe Monitorimit të Rreziqeve Natyrore (QKPMRN);
- Të realizojë shkëmbimin e informacionit brenda dhe jashtë vendit.
- Të kryejë studime me karakter përgjithësues dhe aplikativ në Hidrologji dhe Hidraulikë.
- Të sigurojë vrojtime në kohë dhe hapësirë në përputhje me standardet ndërkombëtare, të kalibruara duke ofruar dhe publikime periodike të tyre.
- Hartimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të integruar monitorimi mjedisor për ujin. Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave.
- Të informojë në rast ngjarjesh ekstreme hidrologjike, organizmat përkatës dhe publikun me komunikata zyrtare nga autoritetet përgjegjëse
- Shërbime në fushën e hidrologjisë dhe hidraulikës për të tretë.

### Monitorimi i aktivitetit hidrologjik

Departamenti i Hidrologjisë ka një rrjet prej 118 stacionesh hidrologjike në gjithë territorin e Shqipërisë, të shpërndara në zonat: Shkodër-Lezhë, Kukës, Peshkopi, Mat-Fan, Elbasan, Korçë, Tiranë-Durrës, Gjirokastër, Berat, Fier-Vlorë, dete dhe laguna dhe puset. Nga të cilat 25 janë automatike, stacionet manuale kontrollojnë stacionet automatike.

Nga këto 118 stacione mungojnë 10 stacione përkatësisht i Valbonës (gri), Fani i madh Breg, Labinot Mal Shkumbini, Vjosa Dorës, Uji i Ftohtë Vlorë dhe 5 stacione puse.

Në 4 stacione përkatësisht Shkumbin Rrogozhinë, Gjolja Ura e Gjoles, Gjanica Panahor dhe Laguna Orikum mungojnë vrotuesi.

Të kryhet kontrolli i vazhdueshëm i këtyre stacioneve pasi sipas raport informacionit mbi gjendjen e stacioneve hidrologjike e nëntorit 2022, rezulton se disa stacione nuk punojnë ose janë vjedhur, por mungon informacioni kur kanë ndodhur këto, e cila duhet të raportohet sektorit të financës.

### Kërkimi shkencor:

Gjatë periudhës objekt auditimi nga Departamenti i Hidrologjisë ka patur publikime artikujsh dhe pjesëmarrje në konferenca sipas tabelës nr.6.

Tabela 6: Të dhëna mbi veprimtarinë kërkimore shkencore të Departamentit të Hidrologjisë:

<i>Nr.</i>	<i>Departamenti</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Numri</i>
		<b>2020</b>	
1	Departamenti i Hidrologjisë	Artikuj në revista dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit	3
2		Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare	3
3		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	5
		<b>2021</b>	
1	Departamenti i Hidrologjisë	Artikuj në revista dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit	2
2		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	6
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare	4
4		Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare	4
5		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	5
		<b>2022</b>	
1	Departamenti i Hidrologjisë	Artikuj në revista dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit	4
2		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	3
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare	2
4		Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare	3
5		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	5

*Burimi IGJEO, punuar nga grupi i auditimit.*

Etapat e ndjekura nga Departamenti i Hidrologjisë për publikim dhe pjesëmarrje në konferenca janë:

- Fillimisht realizohet grumbullimi i të dhënave. Këto të dhëna grumbullohen nga punimet bashkëkohore të studiuesve të fushës nëpër botë, programet e parashikimit të instaluar në Serverin e Qendrës Kombëtare të Parashikimit dhe Monitorimit të Rreziqeve Natyrore, si dhe vrotimet në terren;

- Analizimi i rezultateve dhe përmirësimi i tyre për fitimin e rezultateve sa më të besueshme. Këto analizime bëhen nëpërmjet ballafaqimit të të dhënave me arritjet bashkëkohore, ballafaqimit të parashikimit me ngjarjet e ndodhura, interpretimeve të të dhënave;
- Arritja e konkluzioneve me interes shkencor dhe praktik. i kushtohet një rëndësi e veçantë interpretimit të rezultateve në pjesën e diskutimeve dhe konkluzionet mbi të cilat ngrihen dhe rekomandime për studime të ardhshme apo për ndërhyrje strukturore etj;
- Kërkesa për financim;
- Aplikimi për publikim në revista apo për prezantim në konferenca dhe ruajtja e kontakteve të vazhdueshme me bordet editorial për botimin final.

Në drejtimin e vlerësimeve të Biomassës ka qenë mjaft e reduktuar e cila ka qenë në objektivat e institucionit duke filluar nga viti 2020.

Në lidhje me vlerësimin e rrezikut nga përmbytjet fillimisht kanë përcaktuar paraprakisht zonat me risk përmbytje, e cila është realizuar me anë të projekteve G. dhe P., duke marrë informacion nga ngjarjet e kaluara dhe të dhënat meteorologjike dhe hidrometrike. Rreziku i përmbytjeve nga lumenjtë hartohen hartat nisur nga vlerësimi i prurjeve me siguri 1 herë në 50 vjet, 1 herë në 100 vjet dhe 1 herë në 200 vjet. Hartat e rrezikut të përmbytjeve janë miratuar dhe nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.




Figura 2 Harta e rrezikut nga përmbytjet me periudhe kthimi 1 here ne 100-vjet

### 3. Departamenti Meteorologjisë

Departamenti i Meteorologjisë (DM) është njësi kërkimore bazë e Institutit të Gjeoshkencave (IGJEO), Departamenti i Meteorologjisë ka për mision dhe kryen veprimtari si mëposhtë:

- Të mbajë në gjendje funksionale Sistemin Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik (SKMM), duke e përmirësuar dhe optimizuar atë, vlerësimin e situatave të emergjencave civile ashtu dhe për

vlerësimin e pasurive të burimeve të klimës, të domosdoshme për një zhvillimin të qëndrueshëm e progresiv të vendit dhe përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë. Informacioni meteorologjik paraqet në momente të caktuara një rëndësi të veçantë për sigurinë kombëtare.

- Të realizojë shkëmbimin e informacionit brenda dhe jashtë vendit.
- Të kryejë studime me karakter përgjithësues dhe aplikativ në Hidrologji dhe Hidraulikë.
- Të sigurojë vërtetime në kohë dhe hapësirë në përputhje me standardet ndërkombëtare, të kalibruara duke ofruar dhe publikime periodike të tyre.
- Hartimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të integruar monitorimi mjedisor për ujin, ajrin dhe erozionin e tokës. Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave për elementet e mësipërm.
- Të informojë në rast ngjarjesh ekstreme të motit, organizmat përkatës dhe publikun me komunikata zyrtare nga autoritetet përgjegjëse
- Ndërtimi, mirëfunksionimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kombëtar të stacioneve meteorologjike;
- Matjet dhe vërtetimet e elementeve dhe dukurive meteorologjike në stacionet e vendosura në terren.

### Monitorimi i aktivitetit

Departamenti i Meteorologjisë ka një rrjet prej 113 stacionesh matje në gjithë territorin e Shqipërisë.

Nga këto 113 stacione, stacionet Dushmani, Kallmet, Kllojkë, Shmil nuk kanë asnjë pajisje, pra stacione funksionale janë 109.

Të kryhet kontrolli i vazhdueshëm i këtyre stacioneve pasi ka mospërputhje midis numrit të stacioneve sipas listës vënë në dispozicion grupit të auditimit dhe stacioneve sipas listpagesave në sektorin e financës.

Vlerësimi i risqeve klimaterike jepet nga studimet e kryera nga Departamenti i Meteorologjisë.




Figura 3 Harta me vendmatjet meteorologjike

### Kërkimi shkencor:

Gjatë periudhës objekt auditimi nga Departamenti i Meteorologjisë ka patur publikime artikujsh dhe pjesëmarrje në konferenca sipas tabelës nr.7.

Tabela 7: Të dhëna mbi veprimtarinë kërkimore shkencore të Departamentit të Meteorologjisë:

Nr.	Departamenti	Përshkrimi	Numri
		2020	



1	DM	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit	7
2		Artikuj dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit	2
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	3
4		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	2
5		Studime Shkencore	1
		<b>2021</b>	
1	DM	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit	12
2		Artikuj dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit	1
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	4
4		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare	7
5		Studime Shkencore	1
		<b>2022</b>	
1	DM	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	2

*Burimi IGJEO, punuar nga grupi i auditimit.*

#### **4. Departamenti i Sizmologjisë**

Departamenti i Sizmologjisë është një njësi bazë kërkimi në Institutin e Gjeoshkencave (IGJEO), i cili kryen detyrat:

- Monitoron dhe regjistron aktivitetin sizmik në Shqipëri dhe rreth saj;
- Përdor dhe administron Rrjetin Kombëtar Sizmologjik Shqiptar (RrKSSh);
- Garanton shpërndarjen në kohë reale të informacionit mbi tërmetet dhe mbështet aktivitetet e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) për menaxhimin e Riskut Sizmik me anë të aktiviteteve operacionale dhe kërkimore-shkencore në kuadër të parapërgatitjes, zvogëlimit dhe reagimit;
- Ndërmerr kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar në fushën e Sizmologjisë dhe Sizmologjisë Inxhinierike;
- Ndërmerr shërbime në fushën e Sizmologjisë për palë të treta.

##### **Monitorimi i aktivitetit**

Departamenti i Sizmologjisë monitoron në mënyrë të pandërprerë 24/7 aktivitetin sizmik në territorin e Shqipërisë, me anë të 21 stacioneve të shpërndara në gjithë territorin e RSH-së.

Rrjeti sizmologjik përbëhet nga rrjeti sizmometrik i lëkundjeve të dobëta (bandgjerë) të shpërndara në 14 stacione nga 21 të tilla dhe rrjeti akselorometrik i lëkundjeve të forta (akselerografik) të shpërndara në 17 stacione nga 21 të tilla dhe rrjeti gjeodinamik i përbërë nga 8 stacione të shpërndara në territorin e RSH-së, ku rrjet me 8 stacione në vitin 2023 i ka kaluar Departamentit Gjeologjik.

##### **Integrimi i kërkimit me formimin universitar**

Departamenti i Sizmologjisë ka vënë në shërbim të punimeve shkencore si dhe mbrojtjes së gradave shkencore nga studentët që kanë qenë nën supervizionin e stafit tonë akademik, softet dhe të dhënat unike që disponon si produkt i infrastrukturës moderne në stacionet sizmike.

Përsa i përket kontributit të dhënë ndaj doktorantëve të rinj, që kanë kërkuar mbështetjen nga IGJEO, gjatë periudhës 2020-2022, janë tre anëtarë të stafit akademik si doktorantë aktiv.

##### **Kërkimi shkencor:**

Departamenti i Sizmologjisë ka hartuar hartën probabilitare të rrezikut sizmik për Shqipërinë, ku jepet harta tektonike e Shqipërisë, rajonizimi sizmik. Gjithashtu dhe me anë të studimeve të realizuar nga Departamenti Sizmologjisë.




Figura 4 Harta tektonike e Shqipërisë

Gjatë periudhës objekt auditimi nga Departamenti i Meteorologjisë ka patur publikime artikujsh dhe pjesëmarrje në konferenca sipas tabelës nr.8.

Tabela 8: Të dhëna mbi veprimtarinë kërkimore shkencore të Departamentit të Sizmologjisë:

Nr.	Departamenti	Përshkrimi	Numri
<b>2021</b>			
1	DS	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda dhe jashtë vendit	13
2		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	2
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare	7
4		Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare	3
5		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	3
6		Studime Shkencore	1
<b>2022</b>			
1	DS	Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda dhe jashtë vendit	7
2		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare	3
3		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare	3
4		Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare	2
5		Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	5
6		Studime Shkencore	2

Burimi IGJEO, punuar nga grupi i auditimit.

Një nga detyrat dhe funksionet e IGJEO është dhe vlerësimi i riskut dhe rrezikut sizmik, hidrologjik dhe ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve natyrore, nga grupi i auditimit për gjatë periudhës objekt auditimi rezultoi se në strukturën e IGJEO mungon një njësi e specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore brenda fushës së veprimtarisë së Institucionit, si një nga fushat prioritare të veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	<i>Veprimtaria e Institutit të Gjeoshkencave</i>
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- IGJEO nuk disponon laborator për kryerjen e analizave të ndryshme, i cili referuar rregullores së Departamentit të Gjeologjisë e vitit 2022, neni 30-32 Departamenti i Gjeologjisë ka dhe laboratorin në Institut.</li> <li>- Mungon një dokumentacion / regjistër i arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, si gjurmë mbi zbatimin e një prej pikave kryesore në misionin e Institucionit, që ka të bëjë me formimin universitar, i thelluar, të studentëve dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj.</li> <li>- Gjatë periudhës objekt auditimi puna studimore mbi vlerësimin i Biomassës ka qenë mjaft e reduktuar nga ana e Departamentit të Hidrologjisë, studimi i së cilës është ndër objektivat e institucionit.</li> <li>- Mungojnë të dhëna mbi zhvillimin të modeleve gjeo-informatike gjatë periudhës objekt auditimi, e cila është një nga detyrat e Institutit referuar rregullores në fuqi.</li> <li>- Mungon në strukturën e IGJEO një njësi e specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore brenda fushës së veprimtarisë së Institucionit, si një nga fushat prioritare të veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;</p> <p>VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”;</p> <p>Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 11.01.2019 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë;</p> <p>Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Rektoratit të UPT nr. 54, datë 05.03.2021.</p> <p>Rregullore e brendshme të Departamenteve.</p>
<b>Ndikimi:</b>	Mos plotësimi i disa nga pikave më të rëndësishme të misionit dhe detyrave të Institutit të Gjeoshkencave.
<b>Shkaku</b>	Mos zbatimi i detyrave sipas rregullores dhe pikave të misionit të Institutit nga Departamentet e IGJEO-s.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i institucionit të IGJEOs dhe drejtorët e departamenteve përkatëse, sipas detyrave të tyre funksionale të marrin masa për ngritjen e laboratorit, mbajtjen e një regjistri të arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, zhvillimin e studimeve mbi biomasën dhe zhvillimin e modeleve gjeo-informatike. Gjithashtu ngritjen dhe përfshirjen në strukturën e IGJEO-s të një njësie të specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore, me qëllim arritjen e objektivave të Institucionit.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mungesa e procedurave të inventarizimit nga Instituti i Gjeoshkencave.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi rezulton se nuk janë kryer procedurat e inventarizimit fizik të pasurisë për stacionet sizmike, hidrologjike dhe meteorologjike, pronësi e IGJEO-s, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 74.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
	Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Rektoratit të UPT nr. 54,

	datë 05.03.2021. Rregullore e brendshme të Departamenteve.
<b>Ndikimi:</b>	Risku i monitorimit të gjendjes reale të asetëve në pronësi të Institutit.
<b>Shkaku</b>	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me hapat që duhen ndjekur gjatë procesit të kryerjes së inventarizimit.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i institucionit të IGJEO-s, të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve në pronësi të Institutit, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

## 2.5. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga auditimi i ushtruar në Institutin e Gjeoshkencave (ish Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë Ujit dhe Mjedisit (ish-IGJEUM), për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2019 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar me vendim nr. 61, datë 31.05.2020 dhe “Mbi zbatimin e rekomandimeve” të lëna nga grupi i mëparshëm i zbatimit të rekomandimeve dërguar me shkresën nr. 243/6, datë 18.03.2021, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

Janë rekomanduar gjithsej:

**a.** 9 masa organizative, nga të cilat 2 ishin zbatuar pjesërisht, 4 ishin në proces zbatimi dhe 3 ishin të pa zbatuara gjatë auditimit për zbatimin e rekomandimeve.

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** IGJEUM nuk ka analizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat për trajnim të punonjësve për Sigurinë e Informacionit, në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij instituti.

**1.1 Rekomandim:** Strukturat Drejtuese në IGJEUM të hartojnë plane për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sigurinë e informacionit në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij instituti.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit: *Nga ratifikimi i marrëveshjes në UPT dhe Rrjetit Akademik Shqiptar pritet të ketë plane të detajuara për kualifikime dhe Rritje e Sigurisë Kibernetike në Fushën e Teknologjisë së informacionit. Marrëveshje Bashkëpunimi R.-U., datë 2023- rrjeti 2023*

**Komenti i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion vëren se nuk ekziston ende një plan konkret për zhvillimin e trajnimeve por janë marrë masa për fillimin me marrëveshjen e nënshkruar, **zbatimi i rekomandimit është në proces.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se IGJEUM nuk ka asnjë menaxhim dhe informacion se çfarë ndodh në rrjetin DATA në të gjitha pikat e saj, duke cenuar sigurinë e informacionit. Gjithashtu mungesa e aksesit dhe mos konfigurimi i saktë, ndikon në rritjen e mundësisë së hyrjes të paautorizuar në sistemet dhe databazat e IGJEUM.

**2.1 Rekomandim:** IGJEUM dhe UPT të marrin masat për planifikimin e ndërtimit të një sistemi monitorimi, i cili të monitorojë Infrastrukturat Network, OS, Sigurinë dhe trafikun në kohë reale. Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit: *IGJEO (ish-IGJEUM) menaxhon informacionin se çfarë ndodh në rrjetin DATA në të gjitha pikat e saj, duke garantuar sigurinë e informacionit. Të dhënat sizmologjike monitorohen dhe procesohen nga software komerciale të firmës N., G. si edhe nga një software o. s. S. Të dhënat validohen për saktësi dhe arshivohen në realtime. Ky është një cikël i mbyllur dhe nuk lë vend për gabime. Programet janë të instaluar lokalisht dhe aksesit nga jashtë është i pamundur.*

### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion vëren se **rekomandimi është zbatuar.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit nuk ka një regjistër risku për Teknologjinë e Informacionit ku të jenë evidentuar ato situata të mundshme apo ngjarje të cilat mund të kenë efekt negativ në mbarëvajtjen e punës së këtij institucioni, duke mos pasur kështu një plan masash për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që mund të ndodhin.

**3.1 Rekomandimi:** IGJEUM të marrë masat për hartimin e një regjistri risku për teknologjinë e informacionit ku të jenë evidentuar ato ngjarje të mundshme të cilat mund të kenë efekt negativ në mbarëvajtjen e punës institucionale, me qëllim krijimin e një plani pune në rastet e shfaqjes së problematikave të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

*Përgjigja e Institucionit: Infrastruktura IT në institutin e Gjeoshkencave ka filluar të bëjë ndryshime rrënjësore në sigurinë e mbrojtjes së informacionit dhe minimizimin e riskut teknologjikë. Ndërhyrjet në infrastrukturën IT të IGJEO 2023 nr. 4 datë 04.01.2023.*

### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion vëren se **zbatimi i rekomandimit është në proces.**

**4. Gjetje nga auditimi:** IGJEUM nuk ka politika të aprovuara për menaxhimin e ndryshimeve, e cilat të përmbajnë kontrollet e përshtatshme përgjatë ciklit të ndryshimit, si dhe nuk disponon procedurë për iniciimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiave për kryerjen e ndryshimeve.

**4.1 Rekomandim:** Strukturat Drejtuese në IGJEUM në të ardhmen të marrin masat e nevojshme për hartimin e procedurave mbi menaxhimin e ndryshimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe dokumentimin e gjithë procesit të ndryshimeve.

Menjëherë

*Përgjigja e Institucionit: Në këtë moment të dhënat online janë vetëm të dhënat e rrjetit Sizmologjik. IGJEO ka një website të ndërtuar nga stafi i Arkivit i cili bëhet update dhe mirëmbahet në baza ditore. Përgjegjës për uebin është Msc. A. Gj. por autorizimi për ndryshime jepet nga drejtoria dhe shefat e departamenteve. Tërmetet publikohen në kohë reale si edhe buletinet përmbledhëse çdo muaj.*

*Të dhënat e rrjeteve Hidro dhe Meteorologjik përdoren vetëm në funksion të parashikimit, monitorimit dhe paralajmërimit në kohe reale të rreziqeve natyrore si moti ekstrem, përmytjet apo rrëshqitjet (të dhënat bruto nuk disponohen për publikun), strukturat përkatëse të shtetit për emergjencat civile dhe publikun, AMBU, AKMC, ASIG dhe gjithë partnerëve që bashkëpunojmë.*

*Çdo ditë jepen parashikime 24-orësh online për publikun e gjerë si edhe çdo muaj publikohen buletine në formatin PDF. Proces i automatizuar.*

### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se IGJEUM nuk ka Marrëveshje në Nivel Shërbimi (MNSH/SLA), për mirëmbajtjen e sistemeve, veprim në kundërshtim me pikën 2 të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit,

vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, pika 2, ku citohet: “Çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim 12 informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (Service Level Agreement - SLA)”. Mirëmbajtja e sistemeve kryhet nga vetë personeli në rastet kur ka probleme, por në asnjë rast nuk kemi një monitorim të dokumentuar.

**5.1 Rekomandimi:** IGJEUM në bashkëpunim me UPT të marrin masat e nevojshme për lidhjen e një marrëveshjeje në nivel shërbimi me qëllim garantimin e vazhdimësisë pa probleme të sistemeve që zotëron.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit: *UPT(IGJEO si pjesë e Strukturave të UPT) ka Marrëveshje në Nivel Shërbimi (MNSH/SLA), për mirëmbajtjen e sistemeve, veprim në përputhje me pikën 2 të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar, pika 2, ku citohet: "Çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (Service Level Agreement SLA). Marrëveshje Bashkëpunimi R.-U., datë 2023- rrjeti 2023.*

#### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit nuk ka në përbërje strukturë të teknologjisë së informacionit, madje asnjë pozicion specialisti IT, duke krijuar risk të lartë mbi identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme të Teknologjisë së Informacionit në institucion. Si institucion nën varësinë e Universitetit Politeknik të Tiranës, IGJEUM duhet të ketë suportin e specialistëve IT të Universitetit Politeknik të Tiranës. UPT ka në strukturën e tij 7 Fakultete dhe IGJEUM, dhe për mbulimin e problematikave në fushën e IT, ka vetëm 2 specialistë të fushës të atashuar në zyrat e UPT. Në të tilla kushte, problemet që hasen në IGJEUM në fushën e Teknologjisë së Informacionit gjejnë zgjidhje pothuajse gjithnjë nëpërmjet vetë stafit të cilët kanë njohuri në këtë fushë.

**6.1 Rekomandimi:** IGJEUM në bashkëpunim me UPT të marrin masa për krijimin e një strukture të Teknologjisë së Informacionit në IGJEUM, në nivel sektori apo drejtorie, me qëllim përmbushjen e nevojave institucionale mbi identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme të Teknologjisë së Informacionit.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit: *Në institutin e Gjeoshkencave janë punësuar dy Specialist IT dhe E-Learning Msc.A. Gj. dhe Msc.A. T. Në departamentin e Sizmologjisë është ngritur Grupi teknikë: Dok B. R. dhe Msc M. D. Në departamentin e Sizmologjisë është staf akademik me profil Shkenca Kompjuterike: Dr. Rr.B. dhe Dr. M. C.*

*Në departamentin e Hidrologjisë është staf akademik me profil Inxhinieri Kompjuterike: Msc. A.D..*

#### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se IGJEUM ka vetëm 1 (një) punonjës me profil shkenca kompjuterike, i cili në strukturë është staf akademik pranë Departamentit të Sizmologjisë.

Duke qenë i vetmi punonjës me një profil të tillë, i janë dhënë verbalisht kompetenca si: administrim të sistemit sizmologjik, administrim të të dhënave të dy serverave, administrim të faqes Web, kontroll të log-eve të Web; etj. Grupi i auditimit vlerëson se fakti që një punonjës ka profil të tillë, nuk përbën arsye legjitime që ai të ketë këto kompetenca. Kjo zgjidhje e gjetur në kushte të mungesës të një strukture IT, është e papërshtatshme, madje në mungesë të një autorizimi me shkrim nga ana e titullarit, përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave të institucionit.

**7.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të IGJEUM në vijimësi të dokumentojnë çdo autorizim mbi përdorimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, si dhe të caktojnë detyrat administruese të të dhënave në përputhje me detyrat funksionale të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit: *Në kuadër të sa më sipër është ngritur urdhri nga Drejtori "Administrimin e rrjetit informatik në Institutin e Gjeoshkencave nr.451 datë 02.12.2021", Miratimi i kredencialeve nga provaider V.-kalimit të arkivës Rr.B.-A.Gj., Shkresa nr. 376. Prot. datë 18/10/2021 Lënda: Kërkesë për kalimin e arkivës, "domain-it" zyrtar dhe databazës përkatëse të postës elektronike zyrtare të IGJEO, IT-së së Institutit, z. A. Gj., në përmbushje të detyrave të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.*

### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se IGJEUM nuk disponon një Plan Vazhdimësie (BCP) dhe Plan Rikuperimi (DRC) për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, duke krijuar risk për humbjen e të dhënave, veprim në kundërshtim me pikën 1 të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar.

**8.1 Rekomandim:** IGJEUM duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme të marrë masa për ndërtimin dhe hartimin e Planit të Vazhdimësisë dhe Planit të Rikuperimit, duke përfshirë planet për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, hartimin e planit të sigurisë së informacionit dhe implementimin e tij, duke përfshirë ndarjen e detyrave/përgjegjësi të sigurisë në TIK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit: *Të dhënat online janë vetëm të dhënat e rrjetit Sizmologjik. IGJEO ka një website të ndërtuar nga stafi i Arkivit i cili bëhet update dhe mirëmbahet në baza ditore. Përgjegjës për uebin është Msc. A.Gj. por autorizimi për ndryshime jepet nga drejtorja dhe shefat e departamenteve. Tërmetet publikohen në kohë reale si edhe buletinet përmbledhëse çdo muaj.*

*Te dhënat e rrjeteve Hidro dhe Meteorologjik përdoren vetëm në funksion të parashikimit, monitorimit dhe paralajmërimit në kohë reale të rreziqeve natyrore si moti ekstrem, përmytjet apo rrëshqitjet (të dhënat bruto nuk disponohen për publikun), strukturat përkatëse të shtetit për emergjencat civile dhe publikun, AMBU,AKMC,ASIG dhe gjithë partnerëve që bashkëpunojmë.*

*Çdo ditë jepen parashikime 24-orësh online për publikun e gjerë si edhe çdo muaj publikohen buletine në formatin PDF. Proces i automatizuar.*

*- Plani i Vazhdimësisë dhe Plani i Rikuperimit, duke përfshirë planet për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat në ndërhyrjet në infrastrukturën IT të IGJEO 2023 nr. 4 datë 04.01.2023, bashkëlidhur.*

### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimit është zbatuar pjesërisht.**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi investimet e kryera në fushën e Teknologjisë së Informacionit, u konstatua se ato janë në përpjesëtim të zhdrejtë me rëndësinë kombëtare që ka monitorimi i aktivitetit sizmik, meteorologjik dhe hidrologjik. Pasojat e mungesës së investimeve të domosdoshme në drejtim të teknologjisë së informacionit dhe më gjerë, janë vënë re gjatë ngjarjeve të fundit në vend. Konkretisht, referuar regjistrimeve të bëna në dispozicion nga Departamenti i Sizmologjisë në IGJEUM në lidhje me tërmetin e datës 26.11.2019, i cili ka patur impakt në jetë njerëzish dhe dëme të shumta materiale, konstatohet se mungojnë të dhëna të plota nga stacioni i D., i cili është stacioni më i afërt me vatrën e tërmetit. Ky stacion ka regjistruar vetëm 15 sekondat e para të tërmetit, si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike. Nisur nga fakti që gjatë një tërmeti të fortë ekziston një probabilitet i lartë për ndërprerjen e energjisë elektrike, është e domosdoshme pajisja e stacioneve sizmologjike me bateri (UPS) të cilat mundësojnë regjistrimin e të dhënave edhe nëse ndërpritet energjia elektrike. Theksojmë se funksionimi i rregullt i tre rrjeteve sizmike në vendin tonë është i rëndësishme për parashikimin dhe monitorimin e katastrofave natyrore në kohë reale, duke marrë masa në drejtim të mbrojtjes së jetës së njerëzve dhe reduktimin e dëmeve materiale.

**9.1 Rekomandimi:** IGJEUM në bashkëpunim me UPT, duke marrë shkas edhe nga problematikat e shfaqura gjatë tërmetit të datës 26.11.2019, të marrin masat e nevojshme për analizimin e situatës dhe hartimin e një plan veprimi të ndarë në 3 faza, afat shkurtër, afat mesëm dhe afat gjatë, për kryerjen e ndërhyrjeve në sistemet IT si dhe në ambientet fizike ku këto sisteme janë, me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave që këto sisteme kanë, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira të fushës.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit: *Në IGJEO janë bërë investime në infrastrukturën IT, si blerje Workstation model serveri nga UPT 5 nga buxheti i vitit 2021 dhe 3 nga Buxheti 2022. Gjithashtu kemi marrë nga FTI 15 PC të tipit HP workstation. Në buxhetin e 2023 është parashikuar të fillojë investimi i dhomës së standardizuar të serverit dhe përmirësimi i Rrjetit LAN në Godinën e IGJEOS. Kërkesë investimi për dhomën e serverit të standardizuar dhe rrjetit Lan, Ndërtimi i Faqes Web në standardet e institucioneve si IGJEO nga ana e A. e cila i ka rritur integritetin dhe prestigjin brenda dhe jashtë kufijve, E. referon çdo ngjarje sizmike në linkun e faqes zyrtare <https://www.geo.edu.al/>.*

### **Komenti i grupit të auditimit**

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj përgjigjen e institucioni dhe dokumentacionin e venë në dispozicion verën se **rekomandimi është zbatuar.**

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga verifikimi në terren rezultoi se stacioni sizmik i Sh. ka problematika, godina në të cilën ndodhen pajisjet janë në kushte jo të mira dhe mungon infrastruktura. Kjo gjendje sjell një risk për dëmtimin të pajisjeve, gjithashtu cenohet seriozisht aktiviteti i monitorimit sizmik në vend, si marrjes së të dhënave jo të plota dhe të pasakta mbi monitorimin e aktivitetit sizmologjik në vend.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Titullari i institucionit të IGJEO-s në bashkëpunim me UPT të marrin masa për planifikimin dhe realizimin e investimeve të nevojshme në stacionet sizmologjike në vend, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për monitorimin e aktivitetit sizmik në vend.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi rezultoi një shkallë të ulët e realizimit të Investimeve, e cila



tregon se niveli i bashkëpunimit midis Institutit të Gjeoshkencave dhe Universitetit Politeknik të Tiranës është i pamjaftueshëm dhe mbart riskun e ndryshimit të destinacionit të Investimeve të parashikuara për IGJEO nga ana e UPT i cili realizon procedurat e prokurimit për Institucionet e varësisë. Sipas vlerësimit të audituesve shtetëror të pavarur, realizimi i investimit për IGJEO rezultoi të jetë shumë i ulët në krahasim me planifikimin për secilin vit respektiv, përkatësisht për vitin 2021, Shpenzimet kapitale të trupëzuara (Investimet) janë realizuar në masën 8,8%, ndërsa për vitin 2022 janë realizuar në masën 41%.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 12-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** IGJEO të rrisë shkallën e bashkëpunimit me UPT në mënyrë që të merren masa për realizimin e programit vjetor të investimeve sipas planifikimit të fondeve të miratuara në PBA me qëllim të përdorimit sa më eficient të tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në procedurat e rekrutimit në punë të punonjësve dhe administrimit e dokumentacionit të nevojshëm në dosjet e personelit, ka mangësi:

1. Dosjet e personelit dhe disa nga kontratat e rinovuara nuk administrohen nga IGJEO, në kundërshtim me rregullores së brendshme të Institutit.
2. Mungojnë të dhëna dhe informacionet mbi kohën e publikimit të njoftimit në APP në kundërshtim me rregullores së brendshme të Institutit. Në procesverbalin e komisionit ad-hoc të ngritur për vlerësimin e kandidatëve shprehet se komisioni mori vendimin për kalimin e fazës së parë por pa detajuar mbi mënyrat e komunikimit të kandidatëve të shpallur fitues. Kriteret e vendosura nuk janë të unifikuara për sa i përket mesatares, diplomës etj. vendosur jo sipas përcaktimeve në statutin e UPT mbi minimumin e mesatares së ponderuar.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 15-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **3. Rekomandimi:**

**3.1.** Specialisti i personelit në IGJEO, të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3.2.** Titullari i Institucionit të IGJEO-s të marrë masa për përcaktimit e kriterëve të punësimit të unifikuara sipas përcaktimeve në statutin e UPT në të gjitha procedurat e punësimit, dhe praktikat e punësimit të shoqërohet për transparencë me datën e publikimit në APP.

*Në vijimësi*

**4. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi rezultoi se:

- IGJEO nuk disponon laborator për kryerjen e analizave të ndryshme, i cili referuar rregullores së Departamentit të Gjeologjisë e vitit 2022, Departamenti i Gjeologjisë ka dhe laboratorin në Institut.
- Mungon një dokumentacion / regjistër i arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, si gjurmë mbi zbatimin e një prej pikave kryesore në misionin e Institucionit, që ka të bëjë me formimin universitar, i thelluar, të studentëve dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj.
- Gjatë periudhës objekt auditimi puna studimore mbi vlerësimin i Biomassës ka qenë mjaft e reduktuar nga ana e Departamentit të Hidrologjisë, studimi i së cilës është ndër objektivat e institucionit.
- Mungojnë të dhëna mbi zhvillimin e modeleve gjeo-informatike gjatë periudhës objekt auditimi, e cila është një nga detyrat e Institutit referuar rregullores në fuqi.
- Mungon në strukturën e IGJEO një njësi e specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore brenda fushës së veprimtarisë së Institucionit, si një nga fushat prioritare të veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Titullari i institucionit të IGJEO dhe drejtorët e departamenteve përkatëse, sipas detyrave të tyre funksionale të marrin masa për ngritjen e laboratorit, mbajtjen e një regjistri të arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, zhvillimin e studimeve mbi biomasën dhe zhvillimin e modeleve gjeo-informatike. Gjithashtu ngritjen dhe përfshirjen në strukturën e IGJEO-s të një njësie të specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore, me qëllim arritjen e objektivave të Institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi rezulton se nuk janë kryer procedurat e inventarizimit fizik të pasurisë për stacionet sizmike, hidrologjike dhe meteorologjike, pronësi e IGJEO-s, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 74.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Titullari i institucionit të IGJEO-s, të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimin e aktiveve në pronësi të Institutit, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **V. ANEKSE**

Anekset japin informacion mbi:

Aneksi 1. Sqarim rreth llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga KLSH;

## **VI. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT**

Pjesë përbërëse e Raportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur, si më poshtë:

### **a. Akt konstatime:**

Akt Konstatimi nr.1, datë 26.06.2023;

Akt Konstatimi nr.2, datë 26.06.2023;

Akt Konstatimi nr.3, datë 26.06.2023;

### **b. Akt verifikime:**

Akt Verifikimi nr.1;

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

## **ANEKSI I - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.**

### **Llojet e opinioneve të aplikuara nga KLSH.**

#### **Në Auditimin e Përputhshmërisë:**

##### ***a. Opinion i pamodifikuar.***

- Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe nuk ka konstatuar (për çështjet e audituara) aspekte materiale të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara.

- Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë siguri të kufizuar, si dhe në bazë të punës së kryer, asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen që çështja e audituar nuk është në përputhje në aspektin material me kriteret e aplikuara.

##### ***b. Opinion i modifikuar.***

Jepet në ato raste kur audituesi ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe ka konstatuar gabime materiale, ose kur audituesi ka marrë siguri të kufizuar, pasi në bazë të punës së kryer nuk ka siguruar evidencë e mjaftueshme për të mbështetur dhënien e opinionit, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të kenë mospërputhshmëri të aspektit material.

*Opinion i kualifikuar/i cilësuar*, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

##### ***c. Opinion i kundërt.***

Jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme/ e plotë, por devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura.

##### ***d. Refuzim i opinionit.***

Refuzimi i opinionit është një mohim i përgjegjësisë, pasi audituese nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimit për të siguruar një bazë për dhënien e opinionit, për t'u shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me kriteret e aplikuara, si dhe gjykon se efektet e mundshme mund të janë materiale dhe të përhapura.